

NJOFTIM PËR SUBJEKTIN E RIVLERËSIMIT, Z. LUDOVIK DODAJ

06/08/2020

Komisioni i Pavarur i Kualifikimit njofton se pas shqyrtimit të dokumentacionit dhe zhvillimit të seancës dëgjimore në datën 4.6.2020 për subjektin e rivlerësimit, Ludovik Dodaj, bazuar në ligjin nr. 84/2016, sot, në datën 8.6.2020, vendosi:

Konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit, z.Ludovik Dodaj, prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Apelit Durrës.

Vendimi i arsyetuar me shkrim nga trupi gjykues i kryesuar nga znj. Suela Zhegu, znj. Genta Tafa Bungo relatore, z. Olsi Komici anëtar, do t'u njoftohet subjektit të rivlerësimit, komisionerëve publikë dhe vëzhguesve ndërkombëtarë brenda 30 ditëve.

Ky vendim, mund të ankimohet në Kolegjin e Posaçëm të Apelit nga subjekti i rivlerësimit dhe / ose Komisioneri Publik 15 ditë nga data e njoftimit të vendimit të Komisionit. Ankimi depozitohet në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit.